

Fakulteti: Fakulteti shkencave sociale

Lënda: Lojërat dhe lodrat, Profesori lendes, Mr. Emrush Xhemajli

Java XI

Njesia: LODRAT FEMINORE¹

I. KLASIFIKIMI I LODRAVE

Nder studjuesit dhe pedagogët më të njohur që u morën me klasifikimin e Lodrave janë:
Frebeli, Vudvortovi, Frorina, Makarenko dhe Arkini..

Në vijim po paraqesim një nga klasifikimet më të përgjithësuara të tyre:

- 1. Lodrat senzorike**
- 2. Lodrat motorike**
- 3. Lodrat imituese për imitimimin e përjetimeve**
- 4. Lodra arsimore**
- 5. Lodra emotive**
- 6. Lodrat teknike e mekanike**
- 7. Lodrat konstruktive**
- 8. Lodrat për edukatën e punës**
- 9. Lodrat argëtuese**

Edhe materialet e ndryshme shërbejnë si lodra. Materialet që shërbejnë si lodra I ndajmë në:

- 1. Materiali për lojëra shoqërore.**
- 2. Materiali për lojërat receptive**

¹**Detyre lende:** Studenti ndërton dhe e demonstroi një lodër. Gjithashtu në një fletë përcjellëse shfaqen katër parametra: 1. Emri i lodrës. 2. Përshkruan lodrën. 3. Ku klasifikohet në mesin e llojeve të lodrave. 4. Cilat anë sensoro motorike i zhvillon të fëmijë. 5. Pse i plotëson kushtet kjo lodër për të dhënë fëmijëve në përdorim. 6. Për cilin grupmoshë është kjo lodër. 7. Për cilin lloj loje përdoret për të luajtur kjo lodër.

3. Materiali për të shprehurit të fëmijëve.

II. PËRSHTATSHMËRIA E LODRAVE

Lodrat duhet të plotësojnë disa kritere për të mbërritur qëllimin e tyre dhe për të mos e dëmtuar fëmion.

Lodrat duhet të jenë funksionale

Lodrat duhet të jenë të tilla që lehtëmund të ruhet pastërtia e tyre.

Lodrat nuk duhet të jenë të tilla që të mos mund ta dëmtojnë fizikun e fëmisë

Lodrat duhet të jenë të përshtatshme për shqisat e ndijimit (sensorike).

Lodrat duhet të jenë, mundësisht, të qëndrueshme,.



Fusnota ²

² Fusnota 2 paraqet lodrat që rekomandon Fridrih Frebel

III. LODRAT PËR MOSHA TË NDRYSHME

1. Lodrat për vitin e (1-rë) parë

a. Trupi I vetë fëmiut

b. Objektet që mund t'i zë me dorë.

c. Muji I dytë gjer në të katërtin. (muzikë me tinguj me ton të ulët)

- i. Gjithashtu në këtë mosh fillon të vërejë ngjyrat.
- ii. Shiritat, ose objektet me ngjyra të ndryshme I varim 25 centimetra larg, ndërsa me kalimin e kohës edhe më larg.

d. Nga muaji i 4-5 fillon të mbajë lodrën në dorë.

- i. Zilja,
- ii. Kafshët prej gome (më të mëdha që fëmiu most ë mund t'i fus në gojë dhe t'I përbijë)
- iii. Ndonjë lodër prej letre.
- iv. Edhe pas muajit të gjashtëi don lodrat prej gome,
- v. Kubat tingëllues, të cilët dridhen dhe mund t'I gjuaj në dysHEME.
- vi. Kah fundi i vitit të parë fëmiu I don lodrat që mund të kenë ndonjë vrimë ku mund ta fus gishtin (kutitë, enët e ndryshme).
- vii. Ecja me karrocë që e mbajnë prindërit gjithashtu e argëton fëmiun, e gëzon dhe i jep mundësi për të mësuar në ambient të hapur.

2. Lodrat për vitin e (2-të) dytë

a. Rreth fillimit të vitit të dytë fëmija fillon të ecën, të lëviz. Objektet që deri atëhere vetëm i ka vështruar e prekur tani dëshiron t'i lëviz, tua ndërron vendin.

- i. Tingujt e instrumenteve të ndrshme (zilja, pipëza, trumpeta etj.)
- ii. Prej muajit të 13-të deri në muajin e 18-të, fëmiu fillon të ndërtojë vertikalisht andaj I duhen:
-Kubëzat e ndryshëm,

- Zalli
- Enët e ndrushme.
- Libërthat me figura të mëdha (të rriturit u tregojnë me gisht apo edhe u folin se cka janë).

3. Lodrat për vitin e (3-të) tretë

- a. Lodrat fizikurale (në këtë moshë ato i interesojnë shumë fëmijë)
- b. Lodrat që mund t'i shtyjë apo t'i tërheqë (karroca, automobile, aeroplanet, kafshët me rrotë e të tjera).
- c. Lodrat që mund t'i drejtojë vetë (tricikleta, kali për luhatje e të jera).
- d. Zalli, uji, lodrat tjera që mund të luaj me zalle dhe mbi ujë, kafshë e shpezë plastike që rrin mbi ujë, barkëza ...
- e. Për lojërat e fantazisë, që paraqiten në këtë moshë, nevojiten, lodra si: kësula, canta, vegla pune e profesionesh të ndryshme.
- f. Mjete për vizatim dhe pikturim (letra në të cilën vizaton duhet të jetë e madhe për fitimin e shkathtësisë në lojë). Kjo është mosha kur kalohet nga shkarravitja në fazën e vizatimit simbolik.
- g. Muzika, teatri fëmijëror, libërthat me figura etj.

4. Lodrat për vitin e (3-4-të) tretë deri në vitin e (7-të) shtatë.

- a. Triçikleta gradualisht zëvendësohet me bicikletë.
- b. Lodrat e mekanizuara të cilat fëmijë i kurdis dhe të cilat lëvizin.
- c. Plastelina, brumi, kiti, letra, e zëvendësojnë gradualisht zallin.
- d. Materiali për përpunimin e mozaiqeve, "puzzle", etj.
- e. Material i pasur për vizatim dhe pikturim.



f. Kukulla, në këtë mosh është lodra qendrore.

g. Materiale për lojëra të fantazisë.

h. Lodrat muzikore.



i. Liberthata tani duhet të kenë dhe ndonjë ngjarje, jo vetëm me figura të pa lidhur në mes vedi.

j. Lodrat për lojëra shoqërore.

- k. Rekuizitat sportive (Nga viti i 5-të deri te viti i 7-të): sajat, rrotullueset, skijat, trampulinat, rrëshqitëset etj.
- l. Vegla të vogla pune për punë në kopsht.